

KAPITULLI I SHTATË

**E ARDHMJA E KORESË,
E ARDHMJA E BOTËS**

Harmonia botërore fillon në Gadishullin Korean



Më merr aq shumë malli për vendlindjen, sa e shikoj shpesh në ëndërr. Vendlindja ime është shumë larg Seulit, në Xhong-xhu, në Korenë e Veriut. Është një zonë që i ka të dy: edhe malet, edhe detin. Kudo që të jem, dhe në çfarëdo kohe, zemra ime gjithmonë shkon në atë vend ku ka dashuri dhe jetë. Të gjithë jemi lindur në linjën e gjakut të prindërve dhe, ndërsa rritemi, ushqehemi me dashurinë e tyre. Nuk e harrojmë dot vendlindjen tonë, sepse atje është vendi ku toka është e ngopur me dashurinë e prindërve. Ja pse, sa më të vjetër bëhemi, aq më shumë na merr malli për vendlindjen. Është vendi ku janë rrënjët tona dhe vendi ku duhet të kthehemi. Është e vështirë që njerëzit t'i ndërpresin lidhjet me gjërat që janë tepër të rëndësishme për ta. Në vitin 2004 përfundova veprimtarinë në Shtetet e Bashkuara, pas tridhjetë e katër vitesh, dhe u ktheva në Gadishullin Korean, ku qëndron fati qiellor.

Ne s'jemi të vetëdijshëm për kohën e saktë se kur mëngjesi bëhet mesditë. Nuk jemi të vetëdijshëm as për kohën e saktë, kur mbrëmja bëhet natë. Në të njëjtën mënyrë, qeniet njerëzore s'kanë se si të dinë çastin kur Qielli bën punën e tij. Kështu ndodh edhe me jetën tonë. Çastet tona të suksesit apo dështimit kalojnë pranë nesh, ndërsa s'jemi plotësisht të

vetëdijshëm për momentin e saktë kur ata filluan të shpalosen. E njëjta gjë është e vërtetë për kombet. Ne nuk mund të dimë momentin kur fati i mirë, apo i keq, është në atë komb. Fati qiellor është një forcë që lëviz botën; është një parim që vë në lëvizje universin. Megjithëse mund të mos e dimë, ekziston me siguri diçka e quajtur fat qiellor, të cilin Ai që krijoi këtë botë e përdor për të drejtuar providencën e Tij.

Universi lëviz në përputhje të plotë me rregullin e Tij. Të gjitha qeniet në botë mbartin brenda vetes një parim të caktuar, që është vendosur brenda tyre, madje, para se ato të ekzistojnë. Kur lind një foshnjë, askush nuk ka nevojë ta mësojë se si të marrë frymë dhe si të hapë sytë. Foshnja i bën këto gjëra pa u detyruar nga askush. Gjërat që ndodhin vetë mbajnë brenda tyre çelësa të rëndësishëm mbi sekretet e universit.

Shumë dukuri natyrore duket sikur ndodhin vetë. Megjithatë, në realitet, ato nuk ndodhin ashtu. Fshehur brenda dukurive natyrore në univers është një forcë drejtuese për të cilën nuk jemi në dijeni, dhe të cilën nuk e kuptojmë. Është e njëjta gjë me forcat e fatit në univers, ose me fatin qiellor. Me lëvizjen e universit, është e sigurt që do të vijë një kohë e fatit të jashtëzakonshëm. Nëse kuptojmë parimin e universit, sipas të cilit, pranvera vjen pas dimrit dhe pas saj vjen vera, atëherë mund të shohim një të ardhme të ndritshme për Korenë, pas një dimri të gjatë të fatit të keq.

Ata që janë të zgjuar do ta rreshtojnë veten me ligjet dhe ritmet e universit. Kur isha në Amerikë, peshkoja shpesh në lumin Hadson, afër shtëpisë sime. Kam qenë peshkatar i zoti që kur kam qenë djalë, por kishte ditë në Hadson, kur nuk kapja dot asnjë peshk dhe kthehesha në shtëpi i shkurajuar. Peshqit kanë shtigjet e tyre dhe kohë të caktuara, kur kalojnë në këto shtigje. Nëse nuk e dimë ku janë këto rrugë dhe në çfarë kohe ata kalojnë aty, nuk kapim dot asnjë peshk. Vetëm fakti që ka

ujë nuk do të thotë se do të ketë gjithmonë peshq që kalojnë atje. Një njeri që nuk e kupton këtë mund ta mbante kallamin e tij në ujë gjithë ditën e gjithë natën, dhe nuk do t'i sillte asgjë të mirë. E njëjta gjë është e vërtetë me fatin qiellor. Nëse nuk kemi sy për të parë të ardhmen, nuk do ta shohim fatin qiellor edhe sikur ta kemi para syve. Ja pse është e rëndësishme të kemi një kuptim të thellë për fatin qiellor dhe një aftësi për të kapur lëvizjet e tij.

Civilizimi i njerëzimit është zhvilluar gjatë historisë në një lëvizje për nga perëndimi. Qytetërimi kontinental i Egjiptit i la radhën qytetërimit gadishullor të Greqisë dhe Romës dhe, pastaj, u zhvillua në qytetërimin ishullor të Britanisë përpara se të vazhdonte në një qytetërim tjetër kontinental, këtë herë në Amerikë. Qytetërimi vazhdoi lëvizjen e tij për nga perëndimi, duke kapërcyer Oqeanin Paqësor drejt Japonisë. Lëvizja e qytetërimit njerëzor nuk ndaloi atje. Forca, që e ngriti Japoninë në një pozitë kaq të lartë, po lëviz tani drejt Gadishullit Korean. Qytetërimi njerëzor është gati të japë frytë në Gadishullin Korean.

Në mënyrë që qytetërimi ishullor i Japonisë të lidhet me kontinentin, ai duhet të kalojë përmes një gadishulli. Azia, sigurisht, ka edhe gadi-shuj të tjerë, por vetëm Koreja zotëron themel të mjaftueshëm për të trashëguar qytetërimin bashkëkohor. Gadishulli Korean ka pozitën më të përshtatshme gjeopolitike. Është përballë me Japoninë dhe Shtetet e Bashkuara, matanë oqeanit Paqësor. Gjithashtu është e lidhur me kontinentet e Azisë dhe Evropës dhe është në kufi me Kinën dhe Rusinë. Kjo është arsyeja pse Koreja ka qenë një pikë e fokusit në betejat për pushtet midis fuqive të mëdha botërore dhe ka vuajtur shumë si rezultat i kësaj.

Gjatë Luftës së Ftohtë, u përpoqëm të mbijetonim në luftën kundër komunizmit. Edhe tani, shqetësimet dhe interesat e fuqive më të mëdha botërore vazhdojnë të përfshijnë Gadishullin Korean, kështu që Koreja

mbetet e ndarë, në pamundësi të jetë plotësisht në paqe. Ka ardhur koha kur Gadishulli Korean, ku ndeshen interesat e fuqive të mëdha, do të luajë një rol të rëndësishëm në parandalimin e konfliktit ndërmjet këtyre vendeve. Si rezultat do të jetë në pozitën për të udhëhequr pjesën tjetër të botës në prosperitet dhe paqe.

Fati qiellor vjen me një përgjegjësi të jashtëzakonshme. Tani që Gadishulli Korean ka hyrë në fatin e tij qiellor, duhet të luajë një rol të ngjashëm me atë të një kushinete, për të siguruar që këto vende jo vetëm që nuk ndeshen me njëri-tjetrin, por, në vend të kësaj, bashkë-punojnë ngushtë për hir të prosperitetit dhe paqes në botë. Funkzioni i kushinetës është të mbajë boshtin e një makinerie në vendin e tij, ndërsa e lejon atë të rrotullohet lirshëm. Koreja duhet të mbajë marrëdhënie të mira me fuqitë e mëdha dhe të bëhet kështu një kushinete, që lejon paqen të rrotullohet lirshëm nëpër botë.

Unë kam bërë përgatitje intensive për një kohë të gjatë, që Koreja të luajë këtë rol. Mbështeta politikën e glaznostit të presidentit Gorbaçov dhe nxita përmirësimin e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik. Mbështeta gjithashtu edhe reformën e politikën e hapjes së Deng Xiao Ping, në Kinë, duke filluar në fundin e viteve '80. E fillova punën time në Kinë, duke mbështetur universitetin "Janbian" për të themeluar kolegjin e inxhinierisë. Madje, edhe pas incidentit të sheshit "Tiananmen", kur kapitali i huaj ishte duke u larguar nga Kina, vazhduam të qëndronim në Kinë dhe investuam miliona dollarë në Huizhou, në provincën Kuangtung.

Unë nuk e bëra këtë vetëm për arsye ekonomike. Jam një besimtar, jo një sipërmarrës. Besimtar është ai që shikon të ardhmen dhe përgatitet për të. Rusia, Kina, Japonia dhe Shtetet e Bashkuara duhet të mësojnë të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën, duke përdorur kushinetën shpirtërore

të Gadishullit Korean. Gadishulli Korean është i paracaktuar të bëhet boshti i paqes botërore.

Kur fillova të punoj për të përmirësuar marrëdhëniet midis Koresë, Bashkimit Sovjetik dhe Kinës, zbulova se Koreja nuk kishte, madje, as diçka kaq elementare, siç ishte fjalori rus, apo kinez. Shumë pak do të arrihej nëse s'mund të kuptonim as gjuhën e njëri-tjetrit. Kur dëgjova se kishte grupe akademikësh, që kishin ndërmend të fillonin punën për një fjalor kinezisht-koreanisht dhe për një fjalor rusisht-koreanisht, i mbështeta këto dy projekte. Projekti për fjalorin kinezisht-koreanisht u drejtua nga profesori Il Shik Hong, i Institutit për Kulturën Koreane të Universitetit të Koresë dhe disa profesorë në departamentin e studimeve ruse të universitetit, po përpiqeshin për të publikuar një fjalor rusisht-koreanisht. Këta fjalorë janë duke luajtur role kyçe në shkëmbimet midis Koresë, Kinës dhe Rusisë.

Kur një shkëmb qëndron në majën më të lartë të një mali, po filloi të bjerë, do të bjerë deri në pjesën më të ulët të luginës. Kjo përshkruan ndryshimin e fateve të qytetërimit perëndimor. Të gjithë e dinë që Perëndimi arriti zhvillime të pabesueshme nëpërmjet përdorimit të shkencës, por tani rënia morale po e çon atë poshtë, deri në fund të luginës. Fundi i luginës është Lindja, e cila ka zhvilluar një kulturë shpirtërore për mijëra vite me radhë.

Në veçanti, Gadishulli Korean është vendi ku takohet kultura e Lindjes me kulturën e Perëndimit. Gjithashtu është vendi ku Qytetërimi Oqeanik takohet me Qytetërimin Kontinental. Historiani dhe filozofi Osvald Spengler nxori një teori të ngritjes dhe rrëzimit ciklik të qytetërimeve, e cila e sheh me dyshim demokracinë dhe e përshkruan atë si një tip qeverie që po e udhëheq qytetërimin perëndimor drejt shkatërrimit. Ai argumentonte se demokracia vihet në lëvizje nga paraja, dhe se fuqia

korruptuese e demokracisë dhe shenjat e rënies morale të saj përfshijnë rritjen e materializmit dhe kultit të shkencës. Duke parë kulturën e sotme perëndimore, duket se disa nga mendimet e tij ishin profetike. Qytetërimi i Atlantikut që është zhvilluar deri tani, është duke u përballuar dukshëm me një epokë të re: epokën e Qytetërimit të Paqësorit, që është në ngjitje e sipër. Azia, me Korenë që është në pritje për të luajtur rolin qendror, është duke u bërë aktori qendror në historinë e re botërore. Dy të tretat e popullsisë botërore jetojnë në Azi. Të gjitha besimet fetare kryesore, botërore filluan në Azi. Ajo ka shërbyer për kohë të gjatë si rrënja e spiritualizmit njerëzor.

Është e paevitueshme që qytetërimet perëndimore dhe lindore do të bashkohen në harmoni në Gadishullin Korean. Me ndryshimin e shpejtë të botës, fati qiellor po lëviz në drejtim të Koresë me një shpejtësi gjithmonë e në rritje. Sidoqoftë, nëse Gadishulli Korean duhet të luajë vërtet rolin e vet të rëndësishëm në udhëheqjen e botës drejt harmonisë dhe paqes gjatë një epoke të kaosit, atëherë duhet të përgatitet mirë. Duhet të hedhë pas krahëve të kaluarën e damkosur me paragjykime dhe egoizëm dhe duhet të përshëndesë epokën e re me sy të qartë dhe me një zemër të re.

Prej vuajtjes dhe lotëve, në paqe dhe dashuri



Ka një domethënie të thellë në historinë tragjike që koreanët kanë përjetuar deri tani. Koreja ka vuajtur shumë, sepse është e paracaktuar të bëhet themeli mbi të cilin do të shfaqet paqja botërore. Për shkak se ka duruar vuajtje dhe vështirësi për një kohë kaq të gjatë, Koreja mund të bëhet tani kombi qendror, me anë të të cilit Zoti sjell paqe në botë. Megjithëse koreanët kanë përjetuar vështirësi të panumërta, nuk kemi bërë asnjë armik dhe nuk kemi urreyer askënd. Disa prej fqinjëve na kanë shkaktuar vështirësi, por kurrë nuk i kemi parë ata si armiq të papajtuëshëm.

Populli korean ka zhvilluar një kulturë të zemrës që na mundëson të falim edhe armiqtë tanë. Duhet të kesh mjaft kontroll mbi veten që të duash dhe të pranosh një armik. Aftësia për të dashur armikun vjen vetëm pasi dikush ka fituar mbi konfliktet e tij të brendshme.

Njerëzit që persekutohen janë më të afërtit me Zotin. Që dikush të kuptojë zemrën e Zotit, ai duhet të përjetojë zemrën e Tij të përvajshme. Madje, edhe një person që, normalisht, nuk derdh lot do të qante nëse do të humbte familjen dhe vendin e tij. Ai do t'i përgjerohej Zotit me lot në sy. Vuajtja nga vështirësitë e bën njeriun të ketë një zemër që derdh lot dhe qan, por vetëm nëpërmjet kësaj zemre njeriu mund të marrë

bekimin e Zotit. Zoti vjen tek një zemër që është e ngopur në lot. Koreja është bërë një tokë e fatit qiellor, sepse janë derdhur kaq shumë lot brenda zemrës së popullit të saj.

Populli korean nderon paraardhësit e vet. Sado të uritur të jemi, ne nuk do ta shisnim kurrë tokën, ku janë varrosur paraardhësit tanë, për të blerë ushqim. Historikisht kemi ruajtur një mënyrë të menduari që respekton Qiellin. Jemi një komb modern, i qytetëruar, që ende nderon botën e shpirtit. Kur pranuan budizmin dhe konfucizmin, këto i dhanë jetë një kulture të hijshme fetare. Kohët e fundit, edhe traditat e krishtere dhe myslimane kanë filluar të lulëzojnë këtu gjithashtu. Të gjitha këto fe bashkëjetojnë pa konflikt brenda Koresë. Ato përzihen bashkë dhe bashkekzistojnë paqësisht. Çfarë na ka bërë ne një popull kaq unik?

Që në kohët e lashta kemi pasur mendje fetare dhe zemrat tona kanë qenë gjithmonë të hapura për të marrë fjalën e Zotit. Përveç kësaj, koreanët i kanë dhënë gjithmonë prioritet të lartë arsimimit dhe përsosmërisë. Për pasojë, gjuha koreane dhe alfabeti hangul konsiderohen si thesare të dhëna nga qielli. Gjuha jonë është e pasur me mbiemra dhe ndajfolje, që përdoren për të shprehur zemrën njerëzore.

Unë e dua alfabetin që ne përdorim. Jam shumë i dhënë pas termit “Hunminxhongum” që do të thotë “tingujt e saktë për udhëzimin e popullit”. Ky është emri origjinal i alfabetit hangul (shkronjat koreane). Ka një kuptim kaq domethënës. Përsosmëria e hangul-it ka mbijetuar për shekuj, dhe vazhdon t’i ofrojë bukuri komunikimit njerëzor, madje, edhe në këtë epokë dixhitale. Për mua, është me të vërtetë e mahnitshme se si, nëpërmjet një kombinimi të thjeshtë të bashkëtingëlloreve dhe zanoreve, njerëzit mund të komunikojnë dhe, madje, mund të imitojnë të gjithë tingujt e krijimit.

Në tridhjetë vitet e fundit u kam thënë anëtarëve të kishës sonë në

vende të tjera të përgatiten për të ardhmen, duke mësuar gjuhën koreane. Këto kohët e fundit, termi “hallju”, ose “vala koreane” ishte krijuar nga gazetarët në Kinë, për të përshkruar përhapjen e shpejtë të kulturës popullore koreane nëpër Azi. Popullariteti i muzikës pop koreane, tele-novelave dhe filmave artistikë kanë sjellë një rritje të madhe të numrit të njerëzve që mësojnë gjuhën koreane. Ka shumë njerëz tani në Japoni, Mongoli, Vietnam, madje, edhe në Afrikë, që dinë të flasin gjuhën koreane. Kjo nuk është aspak një rastësi. Shpirti banon brenda gjuhës. Arsyeya pse japonezët u përpoqën aq shumë të zhduknin gjuhën koreane, gjatë pushtimit të tyre të dhunshëm, ishte që të shkatërronin shpirtin e popullit korean. Fakti, që shumë njerëz përreth botës tani flasin gjuhën koreane, do të thotë që zemra dhe shpirti i popullit korean po lulëzojnë. Është pikërisht fati qiellor arsyeja pse influenza e kulturës koreane vazhdon të jetë në rritje.

Populli korean nuk dëshiron kurrë t’u bëhet barrë të tjerëve. Kur isha në Amerikë, pashë karakterin kokëfortë të popullit korean. Shtetet e Bashkuara janë një vend që ka shumë përfitime nga sigurimet shoqërore, por koreanët, pothuajse asnjëherë, nuk duan t’i shfrytëzojnë ato. Në vend që të mbështeten tek ndihma që u jep shteti, ata gjejnë mënyra për t’i fituar të ardhurat që të rrisin fëmijët dhe të kujdesen për prindërit e tyre të moshuar. Kështu koreanët tregojnë mbështetjen në forcat e veta. E shikoj këtë gjë edhe tek misionarët tanë në mbarë botën. Ata nuk kanë frikë të shkojnë në një vend, për të cilin nuk dinë shumë. Kjo është e vërtetë jo vetëm për misionarët, por edhe për afaristët. Sapo u jepet një mision, pavarësisht se ku mund t’i çojë ky mision, ata lënë gjithçka dhe nisen. Ata nuk janë të pavendosur ose ngurrues.

Koreanët kanë një shpirt të tillë sipërmarrës, sa mund të shkojnë kudo në botë dhe të bëjnë një jetë produktive. Historia e vuajtjeve që

kemi kaluar, na ka mësuar se nuk ka pengesë të pakalueshme. Jemi mësuar të përballemi me situatat më të këqija dhe t'i kapërcejmë ato.

Kur ka ndonjë festë në lagje, njerëzit konkurrojnë kush e kush të zërë vendin më të mirë për të parë festën. Ky lloj qëndrimi është shumë egoist. Personi që ulet qetësisht në vendin më të keq do të bëhet udhëheqësi i epokës që po vjen. Çdo njeri, që shqetësohet për të futur ushqim më parë në gojën e tij, do të jetë një dështak në epokën që po vjen. Madje, edhe sikur të na duhet të hamë vetëm një lugë ushqim, duhet të mendojmë për të tjerët së pari. Nëse jemi ata që do të marrim fatin qiellor, që është duke ardhur në Gadishullin Korean, atëherë duhet të jemi të vetëdijshëm në pjesën më të thellë të zemrës sonë se “të tjerët” janë më të vlefshëm se “vetja ime”.

Në të kaluarën, gjithçka që deshëm na është marrë. Gjatë pushtimit të dhunshëm të Japonisë, vendi ynë na u mor. Ai u nda më dysh dhe ne u ndamë me forcë nga prindërit dhe vëllezërit e motrat tona të dashura. Kështu që, Koreja u bë një vend i lotëve. Megjithatë, tani duhet të qajmë për botën. Që tani e tutje, në vend që të derdhim lot për veten tonë, duhet të derdhim lot, më sinqerisht dhe në mënyrë më të dëshpëruar për hir të botës. Kjo është ajo çka duhet të bëjë Gadishulli Korean, nëse duam të vazhdojmë të marrim fatin qiellor. Kur veprojmë kështu, fati qiellor mbi Gadishullin Korean do të përhapet në mbarë botën. Populli korean ka një mundësi të madhe për të qenë në qendër të epokës së paqes botërore.

Qëllimi i fesë së shekullit të njëzetënjetë



Shekulli i njëzetë qe koha e ndryshimeve të jashtëzakonshme. Kanë ndodhur më shumë gjëra në atë periudhë njëqindvjeçare se gjatë dymijë viteve të fundit. Ishte shekulli, në të cilin ndodhën dy luftëra botërore dhe, kur, komunizmi u ngrit si një fuqi të madhe dhe pastaj u zhduk. Ishte, gjithashtu, shekulli kur njerëzimi i kthehu shpinën Zotit dhe u zhyt në gjërat materiale. Çfarë mund të themi për shekullin e njëzetënjetë atëherë? Disa thonë se përparimet e shkencës kanë provuar se shumë besime fetare janë thjesht besëtytni dhe të pa lidhje për botën moderne. Megjithatë, unë kundërshtoj dhe them se roli i fesë do të jetë gjithmonë i rëndësishëm, për sa kohë që aspekti shpirtëror i qenieve njerëzore mbetet një realitet dhe ende nuk është arritur një botë e paqes.

Cili është qëllimi i fesë? Është të sjellë botën ideale të Zotit. Fetë ungjillëzojnë sepse dëshirojnë të rrisin numrin e qytetarëve nën sovranitetin e Zotit. Nëse gjithkush do të jetonte nën sovranitetin e Zotit, do të kishim një botë të paqes, ku nuk do të kishte as luftëra dhe as përçarje. Ndalesa përfundimtare e rrugës së ndjekur nga fetë duhet të ishte paqja.

Zoti e krijoi këtë botë nga dëshira për dashuri dhe paqe. Nëse krijojmë ndarje, duke ngulur këmbë që feja jonë është e vetmja rrugë e shpëtimit, shkojmë kundër dëshirës së Zotit. Zoti dëshiron që gjithë popujt e botës të punojnë shumë për paqen, pajtimin dhe bashkë-ekzis-

tencën. Nëse njerëzit thonë se ardhja në kishë krijon përçarje në familjet e tyre, atëherë nuk ngurroj t'u them se duhet të vendosin familjen në plan të parë. Feja është vetëm një mjet për të sjellë botën e përsosur të Zotit; nuk është përfundimi vetë.

Fati i paracaktuar i njerëzimit është të bashkojë të gjitha pikëpamjet që, tani, janë të ndara nga njëra-tjetra. Filozofia që do të udhëheqë njerëzimin në të ardhmen duhet të jetë në gjendje të bashkojë të gjitha fetë dhe filozofitë. I ka ardhur fundi kohës kur një komb qëndron në ballë dhe udhëheq njerëzimin. Edhe epoka e nacionalizmit ka përfunduar.

Nëse vazhdojmë epokën e njerëzve që mblidhen vetëm sipas feve ose racave, atëherë njerëzimi nuk do të mundë të shmangë përsëritjen e luftës. Epoka e paqes nuk mund të vijë kurrsesi, po që se nuk kapërcejmë zakonet dhe traditat kulturore. Asnjë ideologji, filozofi apo fe, që ka influencuar njerëzimin në të kaluarën, nuk është në gjendje të sjellë paqen dhe bashkimin e nevojshëm për të ardhmen. Kemi nevojë për një ideologji dhe filozofi të re, që shkon përtej budizmit, krishterimit dhe islamizmit. Gjatë gjithë jetës sime, u kam bërë thirrje njerëzve, derisa më është ngjirur zëri, të kapërcejnë fraksionet fetare, madje, edhe besimet e tyre fetare.

Ekzistojnë mbi dyqind vende në botë dhe secili ka kufijtë e vet kombëtarë. Një kufi ndan njërin vend nga tjetri, por ndarja e vendeve me kufij nuk mund të ekzistojë përjetësisht. Vetëm feja mund të kapërcejë kufijtë kombëtarë. Megjithatë, fetë, që duhet t'i kishin bashkuar njerëzit, në vend të kësaj, janë ndarë për vete në shumë fraksione, që janë të zëna duke u grindur me njëri-tjetrin. Ata kanë rënë në procesin e të menduarit egoist, që vë në plan të parë fenë ose fraksionin e tyre. Ata harrojnë faktin që bota ka ndryshuar dhe një epokë e re e altruizmit ka aguar.

Nuk do të jetë e lehtë të rrëzohen muret fetare, që kanë qëndruar për

mijëra vjet, por këto mure duhet të bien, nëse duhet të avancojmë drejt një bote të paqes. Fetë dhe fraksionet e tyre duhet të pushojnë grindjet e tyre të pakuptimta, duhet të gjejnë një rrugë të mesme për opinionet e tyre të ndryshme dhe duhet të zhvillojnë rrugë konkrete për të përparuar drejt paqes botërore. Që njerëzimi të jetë i lumtur në të ardhmen, vetëm pasuria materiale nuk do të jetë e mjaftueshme. Është urgjente që kundërshtitë e ideologjive moderne, të kulturës dhe racave, të kapërcehen nëpërmjet kuptimit ndërfetar dhe harmonisë shpirtërore.

Gjithë jetën ua kam bërë këto thirrje një mase njerëzish fetarë të një spektri të gjerë, që i kam takuar anembanë botës: së pari, respekto traditat e feve të tjera dhe bëj çështje të mundur të parandalosh konfliktet dhe grindjet mes feve. Së dyti, të gjitha komunitetet fetare duhet të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për t'i shërbyer botës. Së treti, udhëheqësit e të gjitha feve duhet të punojnë së bashku për të zhvilluar një strukturë që do të na lejojë të përmbushim misionin tonë të përbashkët të vendosjes së paqes botërore. Syri i djathtë ekziston për syrin e majtë dhe i majti për hir të të djathtit. Të dy sytë së bashku ekzistojnë për hir të gjithë trupit. E njëjta gjë mund të thuhet për çdo pjesë tjetër të trupit. Asgjë nuk ekziston për hir të vetes së vet. Feja, gjithashtu, nuk ekziston për hir të vetvetes, por për hir të dashurisë dhe paqes. Kur të arrihet paqja botërore, nuk do të ketë më nevojë për fe. Qëllimi përfundimtar i fesë është të sjellë realitetin e një komuniteti njerëzor të mbushur me dashuri dhe paqe. Ky është vullneti i Zotit.

Nuk është e lehtë të krijosh një mjedis ku zemrat e njerëzve janë të uritura për paqen. Edukimi i vazhdueshëm është zgjidhja e vetme.

Kjo është arsyeja pse iu kushtova projekteve në fushën e edukimit. Themeluam Shkollën Artistike “Sunhua”, madje, para se kisha jonë të ishte e zhvilluar siç duhet.

Shkolla është një vend i shenjtë, ku mësohet e vërteta. Cilat janë të vërtetat më të rëndësishme që duhet të mësohen në shkollë? Së pari, është njohja e Zotit dhe miratimi i ekzistencës së Tij në botën rreth nesh. E dyta, është të njihet origjina themelore e qenieve njerëzore, përgjegjësitë tona dhe mënyra si t'i përmbushim përgjegjësitë, për hir të botës. E treta, është të kuptuarit e qëllimit përse ekzistojnë qeniet njerëzore dhe, pastaj, të krijohet një botë ideale për atë ekzistencë. Këto gjëra mund të kuptohen vetëm pasi të jepet mësim rreth tyre nga dikush, me sinqeritet dhe me përkushtim, për një periudhë kohe të gjatë.

Arsimimi i sotëm synon krijimin e një shoqërie ku fituesi i merr të gjitha, ku ata që dalin të parët shpërblehen me monopolin e lumturisë. Kjo nuk është mënyrë e drejtë e edukimit të fëmijëve. Arsimimi duhet të jetë mjeti me të cilin krijohet një botë ku gjithë njerëzimi mund të jetojë mirë në tërësi. Filozofitë dhe metodat e edukimit, që na kanë zotëruar deri më sot, duhet të bëhen në të tilla që të na lejojnë të përparojmë drejt synimeve të përbashkëta të njerëzimit. Nëse Shtetet e Bashkuara do të duhet të edukonin vetëm për hir të Shteteve të Bashkuara, dhe Britania vetëm për hir të Britanisë, atëherë e ardhmja e njerëzimit do të ishte e errët. Edukatorët dhe mësuesit nuk duhet të mësojnë si jetohej një jetë egoiste, por në vend të kësaj duhet të transmetojnë zgjuarsinë e duhur për të zgjidhur problemet e panumërta shoqërore me të cilat përballemi sot. Roli i dijetarëve fetarë është edhe më i rëndësishëm. Dijetarët fetarë nuk është nevoja të japin mësim rreth teorive të komplikuar dhe rreth superioritetit të feve të tyre përkatëse. Në vend të kësaj, ata duhet t'u japin studentëve zgjuarsinë për të dashur njerëzimin dhe për të ndërtuar një botë të paqes. Ata duhet të japin mësim rreth parimit të vetëmohimit dhe altruizmit. Nuk mund të shpresojmë për një të ardhme të lumtur për njerëzimin, nëse studiuesit nuk marrin në dorë të mësuarit e pas-

ardhësve tanë me parimet e paqes. Njerëzimi është një vëllazëri dhe bota është një familje.

Dija më e rëndësishme, e nevojshme për njerëzimin, vjen nga njohja e zemrës së Zotit dhe e idealit të Tij. Për këtë arsye, roli i fesë vazhdon të jetë i rëndësishëm, veçanërisht në shekullin e njëzetën, kur shkencat dhe teknologjia duket sikur po zëvendësojnë rolin e fesë, për mënyrën e të kuptuarit se si funksionon universi. Fetë në mbarë botën duhet të kuptojnë vendmbërritjen e udhëtimit njerëzor dhe duhet të ndalojnë menjëherë zënkat e dorës së dytë. Ato nuk duhet të luftojnë për të mbrojtur nderin e tyre. Fetë duhet të bashkojnë urtësinë, të kombinojnë energjitë dhe të punojnë me zell për të ndërtuar botën ideale. Ata duhet të harrojnë betejat e së kaluarës, të mbushura me urrejtje, dhe të gjejnë zgjidhje paqësore. Nuk ka rëndësi sa kemi bërë për paqen botërore, ka ende shumë për t'u bërë. Besimtarët, misioni i të cilëve është të udhëheqin njerëzimin drejt botës ideale, nuk duhet të harrojnë për asnjë çast se misioni i tyre i vetëm dhe i vërtetë është të bëhen apostuj të paqes.

Projektet kulturore shprehin krijueshmërinë e Zotit



Në vitin 1988, Seuli mirëpriti Lojërat Olimpike Verore. E pashë këtë ngjarje tamam si një festival të mundshëm të paqes në oborrin tim dhe bëra që shumë nga anëtarët tanë, në mbarë botën, të vinin në Seul për këtë ngjarje. Anëtarët ndihmuan në shoqërimin e atletëve dhe zyrtarët ndërkombëtarë, i duartrokitën ata, u shërbyen atyre ushqim dhe u dhuruan albume me fotografi nga vizita e tyre në Kore. Meqë Kina dhe Bashkimi Sovjetik ishin të dyja pjesëmarrëse në këto lojra, e pashë si një ngjarje që mund të ndryshonte në mënyrë kritike epokën e Luftës së Ftohtë. Shikimi i Lojërave Olimpike si një festival i paqes u dha fuqi të krijojnë harmoni ndërmjet bllokut komunist dhe botës së lirë. Ditën e ceremonisë së hapjes u ula në zonën e zakonshme të stadiumit kryesor “Xhamshil” dhe vëzhgoja me gëzim të madh.

Pas olimpiadës, i ngarkuar me energjinë e tyre, unë themelova skuadrën e futbollit profesionist “Ilhua Çunma”. Skuadra e “Ilhuas” ka fituar disa herë kampionatin dhe ka ndërtuar një bazë të gjerë tifozërie. Që nga ajo kohë kemi themeluar skuadrat e futbollit, “Klubin Atletico Sorokaba”, dhe “Qendrën sportive Nova Esperança” (CENE) në Brazil, që është shtëpia e futbollit samba, dhe vazhdojmë t’i kemi ato edhe sot. Arsyeja që unë zgjodha të krijoj skuadra futbolla është se sporti

më pëlqen. Sportet më kanë pëlqyer që kur isha i vogël, dhe, për një farë, kohe jam marrë me boks dhe me disa arte ushtarake tradicionale. Megjithatë, futbollit është sporti që vazhdon të më pëlqejë edhe tani, që jam në moshë të madhe. Kur isha në shkollë, vrapoja rreth oborrit me zell të madh duke shkelmuar topin, ndërsa tani më pëlqen të shikoj. Kur Kupa e Botës u zhvillua në Kore, kisha tre televizorë të vënë përbri njëritjetrit, në mënyrë që t'i shikoja të gjitha ndeshjet. Nuk më shpëtoi asnjë ndeshje ku luajti përfaqësuesja e Koresë.

Futbolli është një mikrokozmos i jetës. Nuk ka rëndësi sa mirë di ta dribloj topin në fushë, nëse dikush nga skuadra tjetër, më i shpejtë dhe më i talentuar, vjen dhe ma merr topin. Në një çast, gjithçka që kam bërë deri atëherë shkon kot. E njëjta gjë ndodh edhe sikur të dribloj topin nëpër fushë deri afër portës dhe, pastaj, të gjuaj drejt saj; nëse topi godet shtyllën dhe kthehet mbrapsht, aty përfundon gjithçka. Driblimi i topit varet nga unë, por për të bërë golin duhet të marrin pjesë më shumë se një person. Kam nevojë për një shok skuadre, si Xhi Sung Park, që do të më ndihmojë në çastet më kyçe, ose për dikë si Xhong Pjo Li, i cili me shkathtësi do ta tërheqë larg meje skuadrën tjetër.

Personi më i rëndësishëm në skuadër është trajneri, i cili vështron skuadrën në tërësi që nga vijat anësore. Trajneri as nuk vrapon, as nuk bën gola, por fuqia e tij është më e madhe se fuqia e të gjithë lojtarëve të marrë së bashku. Ashtu si një trajner, i cili shikon gjëra që lojtarët nuk i shohin dot dhe jep sinjale, edhe Zoti shikon gjëra që ne nuk i shikojmë dot dhe na jep shenja. Nëse lojtarët ndjekin si duhet udhëzimet e trajnerit, do të fitojnë pothuajse gjithmonë. Por, nëse trajneri bën shenja dhe lojtarët budallenj ose nuk i kuptojnë, ose nuk i marrin parasysh dhe luajnë siç ua merr mendja, atëherë skuadra vetëm do të humbë.

Futbolli është një sport ku ka konkurrencë, dhe dikush fiton ose

humb, por gjithashtu ai ka potencialin të ndikojë në mënyrë domethënëse mbi shtetet dhe të rrisë bashkëpunimin e tyre drejt paqes. Kam dëgjuar se Kupën e Botës e kanë ndjekur dyfishi i numrit të njerëzve që kanë ndjekur Lojërat Olimprike. Kjo na jep një ide se sa shumë njerëz në botë e duan futbollin. Prandaj, ashtu si Lojërat Olimprike, futbollit ka fuqi të bëhet një forcë për harmoninë midis kombeve, racave, feve dhe kulturave. E shikoj futbollin dhe paqen midis kombeve si partnerë me një fuqi potenciale.

Pelé, i cili u emërua ministër i jashtëzakonshëm i Brazilit për sportet më 1995, e vizitoi një herë Korenë dhe kaloi ca kohë në lagjen Hanam-dong të Seulit. Njerëzit e kujtojnë atë si futbollist më të madh në botë. Por Peleja, që unë takova, ishte një aktivist i paqes. Ai donte të sillte paqen botërore përmes futbollit.

Kur e takova, ai qeshte ndërsa më tregonte historinë e një ndeshje në Afrikë. Ai tha: “Një herë luajta në Nigeri, në Afrikë, por ky vend asokohe ishte në luftë. Si mendon ti, si mundëm të luajmë në një vend ku shpërthenin bombat rreth e rrotull? Fatmirësisht, u bë një armëpushim gjatë kohës që ne luajtëm. Ai ishte çasti kur kuptova thellë se futbollit ishte më shumë se sa një sport. Futbollit është një mjet që përdoret nga të gjithë popujt e botës për të krijuar paqen botërore. Pas kësaj vendosa të krijoja një lëvizje për paqen botërore përmes futbollit”.

Në atë moment u ndikova aq shumë nga Pelé, sa që ia shtrëngova dorën fort.

Jetojmë në shoqëri konkurruese, ku ka shumë stres. Stresi krijon tensione në jetën tonë dhe na rrëmben paqen e mendjes. Kur stresi grumbullohet, njerëzit mund të irritohen dhe, nganjëherë, fillojnë të grinden me njëri-tjetrin. Sportet dhe artet janë shembuj të gjërave që na ndihmojnë të ulim nivelet e stresit. Këto na ndihmojnë të shfryjmë dufin

dhe të bashkojmë njerëzimin. U jam dedikuar skuadrave të futbollit, orkestrave simfonike dhe trupave të baletit, sepse këto veprimtari janë mënyra për të sjellë paqen botërore. Pelé e kupton këtë mënyrë të menduari.

Duke qenë dakord me njëri-tjetrin, Pelé dhe unë krijuam një garë të re të përmasave ndërkombëtare, të quajtur Kupa e Paqes, që është zhvilluar çdo dy vjet, nga viti 2003. Sollëm në Kore skuadra futbollit me famë nga gjithë bota. Një konkurrim i ngjashëm për femra, i quajtur Mbretëresha e Kupës së Paqes, është zhvilluar çdo dy vjet.

Në verën e vitit 2009 zhvilluam për herë të parë Kupën e Paqes për djem, jashtë Koresë. Konkurrimi i vitit 2009 u zhvillua në rajonin e Andaluzisë, në Spanjë. Të gjitha përfitimet nga këta turne përdoren për të mbështetur aktivitete futbollistike për fëmijë dhe të rinj në vendet në zhvillim. Veçanërisht, ne e përdorim futbollin për të ndihmuar fëmijët me paafësi fizike, që të ata mbajnë gjallë ëndrrat e tyre.

Në bashkëpunim me Zyrën e Komisionarit të Lartë për Refugjatët në Kombet e Bashkuara, zhvilluam një turne futbollit për të rinjtë në Liberi. Ky është një vend, populli i të cilit është rraskapitur nga lufta pesëmbëdhjetë vjeçare fisnore. Është nën mbrojtje speciale të Kombeve të Bashkuara, sepse ka një rënie të përshpejtuar të numrit të popullsisë. Fëmijët e këtij vendi të shkalafitur nga lufta u mbledhën për të luajtur futboll dhe për të kënduar këngë të paqes. Duke e goditur dhe duke vrapuar pas topit, ata mësonin aftësitë e punës në skuadër dhe të lojës së ndershme, që janë të nevojshme për të sjellë harmoni midis fiseve.

Organizata e Kupës së Paqes, gjithashtu, ka synim të ndërtojë një stadium të paqes në rajonin Izrael-Palestinë-Jordani, sa më afër kufirit Izrael-Palestinë. Stadiumi do të jetë në dispozicion të të gjithëve, pa përjashtim, si një sipërmarrje për ndërtimin e paqes. Duam të sjellim

trajnerë me famë nga Evropa dhe të fillojmë një akademi futbollit për fëmijët e atij rajoni. Të rriturit mund të duan të drejtojnë armët ndaj njëri-tjetrit, ndërsa fëmijët do të duan të vijnë në stadium dhe të shkelmojnë topin lart e poshtë. Njerëzit thonë se kjo nuk është realiste dhe tundin kokën, por ne do ta bëjmë këtë. Një anëtar i qeverisë izraelite ka thënë se stadiumi duhet të ndërtohet në tokën e Izraelit, kurse një anëtar i qeverisë së Palestinës thotë se duhet të ndërtohet në tokën palestineze. Megjithatë, jam i vendosur ta ndërtoj atë në mënyrë të tillë, që të lidhë të dyja anët. Nuk jam nga ata që detyrohen të heqin dorë nga ëndrrat e tyre. Kam një forcë vullneti si ajo e demit, që e përdor për të ndjekur ëndrrat që do të çojnë drejt një paqeje botërore.

Krijimi i trupës sonë të baletit është një shembull tjetër i së njëjtës forcë të vullnetit. Njerëzit thoshin se nuk ishte e mundur. E themeluan Baletin Universal, në vitin 1994 . Sot, në Kore, njerëzve u pëlqen baleti më shumë se kurrë. Në fillim fare, kur krijuam trupën tonë të baletit, Koreja ishte si një tokë djerrë, për sa i përket baletit. Tani Koreja ka, madje, balerinat e veta me famë botërore.

Sa herë shikoj balet, mendoj se kështu duhet të jetë arti në Mbretërinë Qiellore. Kur një balerinë qëndron në majë të gishtave dhe e mban kokën drejt qiellit, ky pozicion më duket tamam si qëndrimi i përsosur, për mënyrën se si duhet të lartësojmë Zotin. Kjo pamje mishëron një dëshirë të zjarrtë. Në balet, qeniet njerëzore mund të përdorin trupin e tyre të bukur, që ua ka dhënë Zoti, për të shprehur dashurinë e tyre për Të. Kjo është forma më e lartë e artit.

Baleti Universal filloi me vënien në skenë të Liqenit të Mjellmave dhe të Arrëthyesit. Ka vijuar me Don Kishotin, Zhizelin, si dhe krijimet origjinale Shim Çung dhe Dashuria e Çunhjang. Është zhvilluar deri atje, sa është njohur ndërkombëtarisht. Baleti Universal ftohet nga teat-

rot më të famshme në botë. Balerinët e saj janë pajisur me bukurinë unike koreane, e cila u shtohet lëvizjeve energjike të baletit perëndimor. Ata çmohen për mënyrën se si harmonizojnë stilin lindor me atë perëndimor në shfaqjet e tyre. Baleti Universal ka një akademi në Uashington D.C. Unë krijova gjithashtu edhe Orkestrën Simfonike të qytetit të Nju Jorkut dhe “Këngëtarët e shpresës së re”.

Artet i mundësojnë njerëzimit të reflektojë idealet e larta, të mishëruara në vetë punën krijuese të Zotit. Zoti e derdhi gjithë zemrën e Tij në qeniet njerëzore dhe në botën që Ai krijoi, ashtu si artistët që investojnë tërësinë e qenies së tyre në punën e tyre. Libri i Zanafillës na lë të kuptojmë sikur gjërat u shfaqën thjesht, me një të folur të Zotit, por nuk është aspak ashtu. Zoti investoi tërë energjinë e Tij në krijimin e ujit dhe të tokës.

Në të njëjtën mënyrë, lëvizjet e balerinave në skenë janë fryti i një procesi krijues, që kërkon investim total. E njëjta gjë mund të thuhet rreth futbollit. Një skuadër futbollit e suksesshme i derdh të gjitha energjitë gjatë nëntëdhjetë minutave të lojës. Në një vrapim të vetëm për të bërë golin, një lojtar derdh edhe pikën e fundit të fuqisë së mundshme, sikur jeta e tij të varej nga ky aksion. Kjo është e ngjashme me atë çka Zoti përjetoi kur krijoi botën.

Të derdhësh gjithçka që ke, të ofrosh veten tënde plotësisht për hir të një çasti të vetëm në kohë, kjo është mënyra se si arrihet madhështia dhe mënyra se si njerëzimi arrin t’i ngjajë Zotit.

Zotërimi i deteve dhe e ardhmja e botës



Historia ka treguar se vendi që kontrollon detet do të udhëheqë botën. Shikoni Britaninë. Njëherë e një kohë ka qenë e pushtuar nga vikingët e Norvegjisë dhe Suedisë. Në shekullin e gjashtëmbëdhjetë, menjëherë pas kurorëzimit, mbretëresha Elizabeta I e kuptoi që, nëse Britania nuk do të kishte kontroll mbi detet, do të humbte gjithçka. Ajo forcoi politikën detare të vendit dhe, në sajë të përpjekjeve të saj të përkushtuara, Britania u bë një fuqi detare. Mobilizoi kapitalin dhe teknologjinë për të ndërtuar anije të forta, i pajisi anijet me marinarë të guximshëm dhe i dërgoi në det. Ata nuk e dinin se çfarë i priste përtej deteve, por rrezikuan jetën për të shkuar atje. Si rezultat, Britania, një komb i vogël ishullor në Atlantik, arriti të zotërojë koloni në të gjitha kontinentet dhe oqeanet, dhe krijoi një perandori.

Qytetërimi perëndimor, me qendër Britaninë, ka njohur zhvillim të jashtëzakonshëm në shkencë dhe teknologji. Në sajë të busullës, anijet britanike shkuan në shumë vende të botës. Njohuritë materiale dhe teknologjia, e zhvilluar në nivelet më të larta, i dhanë këtij vendi aftësi, në sajë të të cilave ajo synoi të pushtojë tërë botën. Koreja dhe shumica e pjesës tjetër të Lindjes kanë ndjekur një metodë tjetër. Bota e Lindjes nuk e flak shpirtin në kërkim të botës materiale. Nëse ka një konflikt ndërmjet materiale dhe shpirtërores, Lindja do të preferonte

të flakte materialen. Prandaj, duke folur në mënyrë të përgjithshme, jeta në Lindje ka qenë më e vështirë se në Perëndim, sepse është më pak e zhvilluar nga ana materiale. Sidoqoftë, në Perëndim shpirti nuk do të jetë përgjithmonë i dominuar nga materialja. Meqë qytetërimi tërësisht materialist sjell degradim, paraqiten vetvetiu shanset për të mësuar nga një Lindje e orientuar më shumë nga shpirtërorja.

Qytetërimi u zhvillua nga Egjipti në Greqi, nga Roma në Britani dhe në Shtetet e Bashkuara, dhe tani po lëviz në drejtim të rajonit të Paqësorit, përreth Gadishullit Korean. Epoka e një qytetërimi të Paqësorit është duke u shpalosur, duke afruar shkencën perëndimore dhe spiritualitetin lindor. Udhëheqësit e kësaj epoke të re do të jenë kombe si Koreja dhe fqinjët e saj aziatikë. Nuk është thjesht një rastësi fakti që Koreja dhe Japonia kanë qenë të afta të shquhen në nivel ndërkombëtar brenda një kohe të shkurtër. Ky zhvillim ishte një pashmangshmëri historike, si tregues i epokës aziatike.

Por, Shtetet e Bashkuara dhe Rusia nuk do të rrinë e të vështrojnë duarkryq ndërsa vendi ynë merr një rol udhëheqës në botë. Ekziston mundësia e një konflikti të madh që mund të përfshijë Shtetet e Bashkuara, Japoninë, Rusinë dhe Kinën, në afërsi të Koresë. Duhet të përgatitemi për këtë ngjarje të paparashikuar në dy mënyra.

Së pari, duhet të krijojmë një lidhje të fortë midis Japonisë dhe Shteteve të Bashkuara dhe ta lidhim këtë të fundit me Rusinë dhe Kinën, në mënyrë që të mbrojmë Korenë. Si mund ta bëjmë këtë? Me një filozofi dhe me një zemër që krijon njëjtësim. E vetmja filozofi që mund të parandalojë luftërat midis feve dhe të hapë rrugën drejt botës paqësore është ajo që deklaron, se njerëzimi është një, pavarësisht racës, kombësisë dhe fesë. Për t'u mbrojtur nga rreziqet e luftës, Koreja duhet të mbjellë filozofinë e njëjtësimit në botë.

Së dyti, duhet të përgatitemi për epokën e re oqeanike. Epoka e Paqësorit është tek dera. Ai që nuk mund të kontrollojë oqeanin, nuk mund të bëhet udhëheqës në periudhën e Paqësorit. Nëse fati qiellor vjen dhe na gjen të papërgatitur, ne nuk do të mund ta shfrytëzonim avantazhin e ofruar nga ky moment. Nëse e dimë që një epokë oqeanike është gati të fillojë, dhe Koreja dëshiron të bëhet lider i kësaj epoke, atëherë ajo duhet të bëjë përgatitjet e nevojshme.

Ka më shumë sesa thjesht peshk, në oqean. Një thesar edhe më i madh është aftësia e tij për të na siguruar energji. Me zvogëlimin e rezervave të naftës bruto, dita-ditës po rritet një ndjenjë krize e pakësimit të burimeve të energjisë. Nëse bota mbetet pa naftë, njerëzimi menjëherë do ta gjejë veten në errësi. Ka një përpjekje për të prodhuar energji alternative nga misri, por kjo nuk duket realiste, ndërkohë që ka pamjaftueshmëri të ushqimit për gjithë popullsinë e botës.

Burimi i vërtetë i energjisë alternative është oqeani. Energjia e hidrogjenit në det përfaqëson të ardhmen e njerëzimit. Dy të tretat e sipërfaqes së planetit është ujë. Kjo do të thotë që dy të tretat e lëndës së parë, që i nevojitet njeriut për të ardhmen, gjenden në oqean. E ardhmja e re e njerëzimit nuk mund të arrihet pa burimet e oqeanit. Vendet e zhvilluara tashmë po nxjerrin naftë dhe gaz natyror nga oqeani dhe po e shesin atë me çmime të larta. Bota sapo ka filluar të zbulojë rezervat e oqeanit. Po afron dita kur njerëzimi do ta gjejë veten në varësi të oqeanit.

Epoka oqeanike nuk do të fillojë pa përpjekjet njerëzore. Në fillim duhet të dalim nëpër oqean. Duhet të dalim me barka dhe duhet të luftojmë me dallgët. Pa pasur një kurajë të tillë, nuk përgatitemi dot për epokën oqeanike. Vendi që zotëron oqeanet do të bëhet fuqi dominuese e botës do ta bëjë botën që të studiojë kulturën dhe gjuhën e tij. Koreja duhet të bëhet kampion i administrimit të Oqeanit Paqësor. Ajo duhet

të kuptojë vullnetin e Krijuesit dhe duhet të administrojë siç duhet burimet e tij.

Shansi i madh në ‘epokën e oqeanit’



Oqeanet mund të bëhen pika qendrore e afrimit të botës. Që të zotërojmë oqeanet, duhet të stërvitemi të jetojmë në to me të njëjtën lehtësi që jetojmë në tokë. Kur stërvis njerëz për peshkim, nis edhe dhjetë barka të vogla, bashkë me një anije të madhe. Kur nisen nga porti, barkat e vogla janë të rimorkiuara pas anijes së madhe. Megjithatë, sapo dalin në det të hapur, ato e marrin vetë përgjegjësinë për veten. Duhet të dinë drejtimin e erës, çfarë ka në fund të oqeanit dhe çfarë rruge po ndjekin peshqit. Duhet t’i mësojnë të gjitha këto vetë.

Më pëlqen të përdor shprehjen “shpirti i Alaskës”. Kjo do të thotë: të ngrihesh në orën pesë të mëngjesit, të dalësh në det dhe të mos kthehesh para mesnatës, kur verës është ende ditë. Personi me shpirtin e Alaskës qëndron në oqean derisa të kapë normën ditore. Nuk mund të bëhesh një peshkatar i vërtetë, nëse nuk mëson të durosh në këtë mënyrë.

Peshkimi nuk është shëtitje për qejf në det. Sado peshk të ketë në oqean, ata nuk do të vijnë dhe të hidhen brenda barkës suaj. Duhet njohuri e specializuar dhe shumë përvojë. Njeriu duhet të dijë si të rregullojë një rrjetë dhe si të lidhë një litar spirance. Pasi të stërvitet intensivisht për t’u bërë peshkatar, ai mund të shkojë kudo në botë dhe të bëhet lider i njerëzve. Të mësosh si të bëhesh peshkatar është një shkollë e mirë lidershipi.

Për të mbizotëruar detet do të nevojiten anije, madje, edhe nëndetëse, që mund të shkojnë kudo në botë. Koreja është tashmë vendi që ndërton numrin më të madh të anijeve në botë. Ajo ka aftësi të bëhet fuqi e madhe detare. Ajo që i duhet tani është një numër më i madh njerëzish të gatshëm të dalin në det.

Koreanët janë pasardhësit e Çang Bo Go, një njeri i pasur që ka jetuar në shekullin e nëntë, i cili drejtoi një sipërmarrje tregtare detare ndërkombëtare dhe që quhej “Mbreti i oqeanit”. Kemi një traditë të gjatë të daljes në det, të përleshjes me dallgët dhe të fitores së betejave.

Natyrshtëm, njerëzit i kanë frikë dallgët. Kur dallgët i kap era, do të bëhen sope. Formimi i dallgëve dhe i sopeve është i nevojshëm që oksigjeni të përzihet brenda oqeanit. Nëse oqeani do të jetë i qetë për një kohë të gjatë, pa erë dhe pa dallgë, ai do të fillojë të vdesë. Kur kuptojmë vlerën e dallgëve, ato nuk janë më diçka që të futin frikën. Edhe sikur të fryjë erë e fortë dhe dallgët të bëhen të frikshme, e kuptojmë që kjo është mënyra për t’i ndihmuar peshqit të jetojnë. Atëherë, dallgët bëhen pjesë e bukurisë e detit.

Tridhjetë metra poshtë sipërfaqes së oqeanit nuk ka dallgë. Nëse do të merrnim një nëndetëse dhe do të shkonim në fundin e oqeanit, atje do të ishte aq freskët, sa nuk do të kishte nevojë për ajër të kondicionuar. Peshqit zgjedhin thellësinë që ka temperaturën e përshtatshme dhe pastaj bëjnë kërcime të mrekullueshme, ndërsa notojnë në tufë në ujërat e tyre të preferuara. Tamam si trupa jonë e valltareve të “Engjëjve të vegjël” me freskoret e tyre, edhe peshqit kanë pajisjet e tyre shumëngjyrëshe dhe lëvizin me delikatesë pendët e tyre të notit. Vendi ku jetojnë ata është mjedis i bukur dhe i qetë. Edhe bota, gjithashtu, do të bëhet së shpejti po aq e paqshme sa ky vend.

Fakti që është duke ardhur një epokë oqeanike, do të thotë se Ko-

reja, shpejt, do të ketë shansin të ndryshojë botën. Njerëzve, që jetojnë në vende gadishullore, përgjatë historisë u është dashur të luftojnë me pushtime si nga toka, ashtu edhe nga deti. Për të mbijetuar, u është dashur të jenë të guximshëm dhe të zhvillojnë një karakter kombëtar të paepur. Nuk është koincidence që qytetërimet u zhvilluan në vende të tilla gadishullore, si Greqia dhe Italia. Qytetërimi mundi të lulëzojë në këto vende, sepse ata patën shpirtin aventurier, të fortë dhe sipërmarrës, që nevojitet për të përhapur ndikimin e tyre si në kontinent, ashtu edhe në det.

A keni dëgjuar rreth “Rrymës së Zezë”, një rrymë kufizuese e Paqësorit të Veriut? Ajo udhëton katër mijë milje (6500 km) në vit, bazuar në tërheqjen gravitacionale të hënës. Kjo është një spirale oqeanike, që vërtitet përgjatë gjithë oqeanit Paqësor. Ta përshkruash thjesht “e tmerrshme”, nuk do të ishte e mjaftueshme.

Të gjitha oqeanet e botës lëvizin në sajë të së njëjtës fuqi, që vë në lëvizje “Rrymën e Zezë” dhe rrymat e tjera oqeanike. Nëse nuk do të ishin këto rryma, uji nuk do të qarkullonte dhe nuk do të kishte jetë. Ashtu si edhe lumi më i madh dhe më i fuqishëm, përfundimisht, duhet të derdhet në det, ashtu edhe oqeanet, sado të mëdhenj të jenë, duhet të lëvizin në përputhje me rryma si “Rryma e Zezë”.

Populli korean duhet të bëhet tamam si “Rryma e Zezë” dhe duhet të bëjë që kultura e tij paqedashëse të rrjedhë dhe të influencojë mbarë botën. Duhet të bëhemi një burim force në botë, vendi ku të gjitha forcat e jetës mblidhen së bashku, në një përqendrim paqësor.

Kam vizituar shumë herë bregdetin jugor të Koresë, në përpjekje për të gjetur vendin që mund të bëhet qendra e një qytetërimi të Paqësorit, dhe besoj se Josu dhe Sunçon janë të përshtatshme për këtë detyrë. Deti i bregdetit të Josu është i qetë dhe i pastër si një pasqyrë. Është vendi ku

admirali Ji Sun Shin u dha një goditje të rëndë japonezëve në fund të viteve 1600 dhe, gjithashtu, vendi ku ai vdiq në betejë e sipër. Josu ka një histori të madhe betejash detare dhe është gjithashtu pika ku takohen rajonet e Jounnamit dhe Honamit. Gjendet në këmbët e malit Xhiri, atje ku të majtët dhe të djathtët u përleshën gjatë Luftës Koreane. Në këtë kuptim, është një tokë e mbushur me dhimbjen e popullit tonë.

Gjiri i Suncheonit, i njohur për shtretërit me kallama, ka një bregdet të bukur dhe me famë botërore. Po të dalësh në atë det me ujërat e pastra, që vezullojnë nën rrezet e diellit, mund të kapësh shumë lloje peshqish. Në ujërat e qeta të këtij gjiri rriten midhje dhe alga ngjyrë kafe. Cekëtinat e gjera baticore janë plot me guaska deti dhe me lloje të tjera butakësh dhe oktapodësh të vegjël. Kam dalë në detin e asaj zone dhe u jam ngjitur edhe maleve, prandaj është e qartë se kjo tokë e bukur ka gjithçka të nevojshme për epokën e ardhme e të Paqësorit.

Tani po zhvilloj bregdetin jugor të Koresë, duke u përqendruar në Josu. Si pjesë e përgatitjeve për këtë, kam vajtur në ishullin Gomun dhe në ishuj të tjerë të asaj zone dhe kam jetuar atje disa muaj. I kam konsideruar njerëzit e atjeshëm, që në dekadat e fundit janë marrë me bujqësi dhe me peshkim, sikur të ishin mësuesit e mi. Kam ngrënë dhe kam fjetur në bujtina modeste dhe kam studiuar gjithçka në detaje.

Nuk kam studiuar vetëm libra. Kam shkuar kudo, duke parë me sytë e mi, duke shkelur me këmbë dhe duke verifikuar gjithçka. Për pasojë, tani e di se ç'loj peshku dhe në ç'pjesë të oqeanit mund të gjendet, ç'loj rrjete duhet të përdoret për t'i kapur dhe ç'loj pemësh rriten në male; dhe cila shtëpi në ishull ka një të moshuar që i mbijetoi ishemisë (humbe e funksionit të trurit për shkak të mosfurnizimit me gjak).

Kur mbarova studimet e mia në bregdetin jugor, mora kryetarin e fshatit, që më pati ndihmuar, dhe e hipa në një avion për në Alaskë. Ai

më kishte mësuar gjithçka që dinte, kështu që doja t'i shpërbleja nderin, duke i mësuar atij gjithçka që dija rreth Alaskës. Shkova me të për peshkim dhe i tregova për llojet e ndryshme të peshqve dhe mënyrën se si kapen ata. Edhe sikur të di shumë pak në lidhje me diçka, nuk ndihem rehat nëse nuk e ndaj atë me të tjerët.


Pak pasi fillova ta zhvilloj Josunë, ai u zgjodh si vendi ku do të zhvillohet një ekspozitë ndërkombëtare detare në vitin 2012. Krahas Lojërave Olimpikë dhe Kupës Botërore, ekspozitat ndërkombëtare janë ndër festivalet më të mëdha në nivel global. Gjatë gjashtë muajve që Expo 2012 do të zhvillohet në Josu, 154 shtete, anëtare të Byrosë së Ekspozitave Ndërkombëtare (BIE), do të organizojnë ekspozita të ndryshme. Kjo do ta përqendrojë vëmendjen e botës në Josu, dhe teknologjia e kultura e vendeve të zhvilluara do të derdhet atje. A i keni parë ndonjëherë në një qiell vere retë që lëvizin me një shpejtësi të habitshme? Kur përfshihen nga era, retë lëvizin shpejt mbi male dhe oqeanë. Tani nuk është koha për të hezituar. Në mënyrë të ngjashme me retë, fati qiellor do ta çojë botën drejt Josusë dhe Gadishullit Korean.

Kam planifikuar t'i lidh gjithë ishujt përgjatë bregdetit jugor me ura dhe të ndërtoj banesa të përbashkëta, ku mund të vijnë dhe të banojnë njerëz që i duan anijet, nga e gjithë bota. Këto nuk do të jenë thjesht komplekse argëtimi. Amerikanët, gjermanët, brazilianët dhe afrikanët do të vijnë të gjithë. Ata mund të dalin me barka të ndryshme në det për të kapur peshk, por unë do t'i nxis të qëndrojnë në të njëjtën strehë, për të treguar se njerëzimi është një familje.

Epoka që po vjen do të jetë, gjithashtu, epokë e aeronautikës, madje edhe e udhëtimeve hapësinore. Po vjen koha kur zotërimi i një teknologjie të zhvilluar të aeronautikës do të jetë një nevojë absolute. Do të jetë tepër vonë që Koreja të përgatisë industrinë e saj të hapësirës,

nëse nuk fillon tani. Për këtë arsye, po përgatis një park industrial aeronautik në Gimpo, në provincën e Kjongisë. Atje planifikoj të prodhoj helikopterë me famë botërore, të të njëjtës cilësi si Sikorski. Shpejt do të vijë dita kur helikopterët, që mbartin markën Teguk të Koresë, do të fluturojnë nëpër qiejt anembanë botës (Teguk është figura kuq e blu në flamurin korean).

Edhe një luleradhiqe është më e çmuar se ari



Tri sfidat e mëdha të shoqërisë moderne janë: zgjidhja e problemit të ndotjes, krijimi i një ndërgjegjësimi për mbrojtjen e mjedisit dhe rritja e prodhimit ushqimor. Toka është shkatërruar, tashmë, në shkallë të gjerë. Lakmia e pafundme për pasuri materiale ka sjellë ndotje serioze të ajrit dhe ujit, gjë që po e shkatërron natyrën, përshirë edhe shtresën e ozonit që na mbron. Nëse prirjet e tanishme vazhdojnë, njerëzimi nuk do të jetë në gjendje t'i shpëtojë pasojave dhe grackave të vrapit të shkujdesur të të mirave materiale.

Gjatë njëzet viteve të fundit, kam punuar për të ruajtur dhe mbrojtur rajonin Pantanal, të Brazilit. Pantanali, një rajon që shtrihet në Brazil, Bolivi dhe Paraguai, është rajoni moçalor më i madh në botë. Ai është në listën e UNESCO-s si trashëgimi botëror. Unë po udhëheq një lëvizje globale mjedisore, për të ruajtur gjallesat e Pantanalit në gjendjen e tyre të mëparshme, në të cilën i krijoi Zoti.

Pantanali, ku uji, toka, kafshët dhe bimët ekzistojnë në harmoni, është vërtet një vend i mrekullueshëm. Fjalët e thjeshta si 'i bukur' apo 'fantastik' nuk të japin as idenë më të vogël të vlerës së tij. Fotot nga lart të kësaj zone janë kaq të bukura, sa koleksionet e tyre janë nga më të shiturat në botë. Pantanali është thesari i çmuar i njerëzimit, ku jetojnë

specie të rralla, si majmuni gushëbardhë, majmuni qimekuq, papagalli shumëngjyrësh, jaguari, anakonda, zogjtë rea, (të ngjashëm me strucin) dhe krokodili kaiman.

Flora dhe fauna e Pantanalit dhe Amazonës duket sikur janë si në mëngjesin e parë pas Krijimit. Pantanali është si Kopshti i sotëm i Edenit. Qeniet njerëzore kanë shkatërruar mjaft qenie që ka krijuar Zoti. Shumë specie të bimëve dhe kafshëve janë zhdukur nga lakmia njerëzore. Megjithatë, në Pantanal format origjinale që krijoi Zoti ekzistojnë ende. Po planifikoj, të krijuar një kafaz zogjsh dhe një rezervat insektesh në Pantanal, për të ruajtur disa nga këto specie unike nga zhdukja.

Përveçse është një vendbanim për shumë bimë dhe kafshë, Pantanali është gjithashtu edhe një burim i rëndësishëm oksigjeni për tokën. Poashtu, është si një magazinë që thith gazrat e serave. Por, në sajë të zhvillimit industrial, Pantanali është duke ndryshuar me shpejtësi. Nëse ajo zonë, e cila bashkë me Amazonën siguron një sasi kaq të madhe oksigjeni për tokën, shkatërrohet, atëherë e ardhmja e njerëzimit do të jetë e zymtë.

Qindra lloje peshqish jetojnë në Pantanal. Njëri prej tyre është ai me ngjyrë ari që quhet “dorado” dhe peshon, zakonisht, mbi njëzet e gjashtë kilogramë. Herën e parë që një dorado ngeci në gripin tim m’u duk sikur u thitha nga lumi. Ndërsa mblidhja fillin e grepit me gjithë forcën, ai kërcente mbi ujë disa herë. Pas disa kërcimeve ende kishte shumë fuqi për të luftuar. Ishte aq i fortë, saqë dukej më shumë si një ari apo tigër, sesa si një peshk.

Liqenet në Pantanal janë thujse gjithmonë të pastër. Çfarëdo t’i hedhësh ujit, shpejt ai pastrohet përsëri. Uji pastrohet shpejt, sepse mjedisi moçalor filtron sedimentet dhe ndotësit, dhe kjo është arsyeja pse ekzistojnë kaq shumë lloje peshqish. Çdo specie ushqehet me diçka të ndry-

shme. Duke jetuar bashkë, në një sistem të ndërlikuar, ato gllabërojnë mbetjet organike që ndotin ujin. Edhe të ushqyerit e tyre ka funksionin e mbajtjes pastër të ujit. Peshqit ndryshojnë shumë nga qeniet njerëzore në këtë aspekt, sepse ata kurrë nuk jetojnë për veten e tyre, por si pjesë e një sistemi të madh ekuilibri. Ata ndihmojnë në pastrimin e mjedisit dhe në përmirësimin e tij.

Ana e prapme e një gjetheje zymbyli në kënetat e Pantanalit nxin nga insektet. Nëse insektet do të mbeteshin atje, zymbyli nuk do të ishte në gjendje të mbijetonte, por ka peshq që i hanë këto insekte. Kështu që insektet jetojnë, zymbyli jeton dhe peshqit jetojnë. Ja si ekziston natyra. Asnjë krijesë nuk jeton për veten e vet. Përkundrazi, ata jetojnë për njëri-tjetrin. Natyra na jep këtë mësim të jashtëzakonshëm.

Nuk ka rëndësi sa shumë peshq mund të ketë në Pantanal. Nëse njerëzit lihen të lirë të peshkojnë atje, sasia e peshkut është e destinuar të zvogëlohet. Për të mbrojtur peshqit, na nevojitet të zhvillojmë rezervatat e peshqve. Për arsye se peshqit në Pantanal janë kaq të çmuar, duhet të zhvillojmë shumë rezervate peshqish. Shërbime të ngjashme duhen për të mbrojtur insektet, zogjtë dhe gjitarët. Pantanali siguron një mjedis të përsosur për të gjitha këto krijesa. Duke u përqendruar në mënyrën se si të rritet numri i tyre, njerëzimi mund të vazhdojë t'u gëzohet atyre për shekuj të tërë.

Nuk janë me bollëk vetëm peshqit në Pantanal. Brigjet e lumenjve kanë ananas, pemë bananesh dhe pemë mangoje. Edhe orizi bëhet atje kaq mirë, sa është e mundur të merren tri prodhime në vit, madje pa e ujitur fare. Kaq pjellore është toka atje. Prodhime, si fasulet dhe misri, mund të rriten thjesht duke hedhur farën në tokë. Nevojitet shumë pak dora e njeriut.

Njëherë, ndërsa ishim duke udhëtuar përgjatë lumit Paraguai me

barkë, ndalua në një shtëpi afër bregut. Bujku që jetonte atje e kup-toi që ishim të uritur, kështu që shkoi në fushë dhe shkuli një patate të ëmbël. Ishte sa një shalqi! Ai na tregoi se, për sa kohë që e linte rrënjën brenda në tokë, ajo do të vazhdonte të prodhonte patate për disa vite rresht. Mendimi që patatet mund të vilen pa i mbjellë vit për vit më zgjoi një dëshirë të fortë për t'i çuar në vendet, ku njerëzit nuk kanë çfarë të hanë.

Njerëzit që promovojnë idenë e zhvillimit të moçaleve, theksojnë përfitimet ekonomike të këtij zhvillimi. Por Pantanal siguron një përfitim të bollshëm ekonomik edhe kështu siç është, në gjendjen e një kënete. Kjo zonë ka pyje të pafundme dhe të virgjëra me dru gjethegjërë. Vendasit thonë se dikush mund të ngulë një gozhdë në njërin nga këto pemë dhe, megjithatë, ajo mund të jetojë mbi njëqind vjet. Këto pemë përdoren për të prodhuar dru abanozi, që nuk kalbet, dhe thuhet se jeton më gjatë se hekuri. Imagjinoni se si do të dukej, po të kishte pyje të tëra me pemë kaq të çmuara. Në Pantanal mbollëm disa fidanë të këtyre pemëve, në një tokë prej katërqind hektarësh. Pemët që kanë mbjellë anëtarët tanë e kanë bërë Pantanalin edhe më të bukur.

Egoizmi njerëzor po shkatërron natyrën. Konkurrenca njerëzore, për të gjetur rrugën më të shkurtër drejt suksesit ekonomik, është arsyeja kryesore pse mjedisi është dëmtuar. Nuk mund të lejojmë që toka të dëmtohet më shumë. Njerëzit besimtarë duhet të udhëheqin përpjekjet për të shpëtuar natyrën. Natyra është krijimi i Zotit dhe dhurata e Tij për njerëzimin. Duhet të punojmë shpejt për të ndërgjegjësuar njerëzit në lidhje me vlerën e natyrës dhe nevojën urgjente për ta risjellë në gjendjen e pasur dhe të lirë, që gëzonte në kohën e krijimit.

Meqë është bërë e njohur gjerësisht se Pantanali është një thesar i çmuar, ka filluar një konflikt në lidhje me të ardhmen e tij. Vendi që

duhet ta mbrojmë po bëhet fushë beteje për njerëz lakmitarë. Në dhjetë vitet e fundit, kam marrë udhëheqës nga vende të ndryshme të botës dhe i kam sjellë në Pantanal. Kam sponsorizuar diskutime mbi mënyrën si të mbrojmë këtë rajon dhe pjesën tjetër të mjedisit botëror. Jam duke mbledhur ekspertët dhe studiuesit më të mëdhenj të botës për mjedisin, për t'i zgjuar interesin e tyre për ruajtjen e Pantanalit. Unë po punoj për të ndaluar shkatërrimin e Pantanalit nga dëshirat e pamëshirshme materiale të qenieve njerëzore.

Teksa çështjet mjedisore bëhen gjithmonë e më serioze, shumë grupe në mbrojtje të mjedisit janë formuar. Por lëvizja më e mirë mjedisore është ajo që shpërndan dashuri. Në përgjithësi njerëzit kujdesen për gjërat që u përkasin atyre, apo për njerëzit që i duan. Megjithatë, ata nuk kujdesen dhe nuk duan mjedisin natyror që krijoi Zoti. Zoti ia ka dhënë këtë mjedis njerëzimit. Ishte vullneti i Tij që të përdorim mjedisin për të prodhuar ushqim, për të pasur me bollëk dhe për të përjetuar gëzimin e të jetuarit në bukurinë e natyrës. Natyra nuk duhet të përdoret njëherë dhe të flaket tutje. Pasardhësit tanë për shumë breza të ardhshëm duhet të jenë në gjendje të mbështeten tek natyra, ashtu siç kemi bërë ne.

Rruga më e shkurtër për të mbrojtur natyrën është të zhvillosh një zemër që dashuron natyrën. Duhet të jemi në gjendje të derdhim lot, kur shohim edhe një fije bari përgjatë rrugës ku ecim. Duhet të jemi në gjendje të kapemi pas trungut të një pemë dhe të lotojmë. Duhet ta kuptojmë se shpirti i Zotit fshihet brenda një plisi ose një shtëllunge të vetme ere. Të kujdesesh dhe të duash mjedisin është njëlloj sikur të duash Zotin. Duhet të jemi në gjendje të shohim çdo krijesë të krijuar nga Zoti si një objekt të dashurisë sonë. Me sytë tanë shpirtërorë të hapur mund të shihnim se një luleradhique e vetme, anës rrugës, është më e vlefshme se kurora e artë e një mbreti.

Zgjidhja e problemit të varfërisë dhe urisë

Nëse nuk jeni kurrë i uritur, nuk mund të njihni Zotin. Kohët kur jeni të uritur janë shanset për të qenë më afër Zotit. Kur je i uritur, je në gjendje të shikosh me përulësi çdo person që të afrohet, sikur ai të ishte anëtar i afërt i familjes që do ta ndihmoje, atëherë ke më shumë shanse t'u ushqyer. Në situata të tilla është e rëndësishme të mbash një zemër të dhembshur të mirësisë.

Uria nuk është çështje që paraqitet në vendet më pak të zhvilluara të botës. Madje, edhe në Shtetet e Bashkuara, të cilat gëzojnë një nga standardet më të larta të jetesës në botë, ka miliona njerëz që janë të paushqyer dhe të uritur. Kur shkova në Shtetet e Bashkuara, një nga projektet e mia të para ishte blerja e kamionëve, që do të përdroreshin për shpërndarjen e ushqimit për të varfrit.

Situata në vendet e varfra është tejet më e keqe. Kur shikoj situatën e botës, e ndiej që sigurimi i furnizimeve ushqimore të mjaftueshme është problemi më i ngutshëm. Zgjidhja e krizës së ushqimit nuk mund të lihet të presë për asnjë çast të vetëm. Madje, edhe tani, rreth njëzet mijë njerëz në botë vdesin për shkak të urisë, çdo ditë. Nuk na lejohet të jemi apatikë vetëm ngaqë ne, apo familja jonë e afërt, nuk përballlet me urinë.

Megjithatë, thjesht, vetëm shpërndarja e furnizimeve ushqimore

nuk do ta zgjidhë problemin e urisë. Nevojitet një trajtim më themelor i problemit. Kam parasysh dy metoda themelore dhe konkrete. Së pari, sigurimi i furnizimeve të bollshme ushqimore me çmim të ulët dhe, e dyta, është shpërndarja e teknologjisë, në mënyrë që njerëzit të mund ta përdorin për të kapërcyer vetë urinë.

Çështja e ushqimit do ta çojë njerëzimin në kriza serioze në të ardhmen. Nuk mund të ndërtojmë një botë të paqes pa zgjidhur më parë çështjen e ushqimit. Furnizime të mjaftueshme ushqimore, për të gjithë popullsinë e botës, nuk mund të prodhohen në sasinë e kufizuar të tokës bujqësore që kemi në dispozicion tani për tani. Duhet t'i hedhim sytë nga oqeani për të gjetur zgjidhje. Oqeanet kanë çelësin për zgjidhjen e krizave ushqimore të së ardhmes. Kjo është arsyeja pse i kam shkelur i pari oqeanet në këto dekadat e fundit.

Në Alaskë, peshku i kuq pollek, më i shkurtër se 40 cm, përdoret për pleh. Me ta mund të përgatiteshin gjellë të mrekullueshme, por njerëzit nuk dinë si t'i gatujnë, prandaj i përdorin thjesht si pleh. Pothuajse njëzet ose tridhjetë vjet më parë, mund t'u kërkonim perëndimorëve të na jepnin bishtin e një kau dhe ata do të na i jepnin falas. Koreanët janë shumë të dhënë pas gjellëve të përgatitura me kockat dhe zorrët e lopëve, por disa perëndimorë nuk e dinë që, këto të fundit, janë të ngrënshme.

E njëjta gjë është e vërtetë me peshkun. Rreth 20 për qind e peshkut të kapur në botë hidhet. Sa herë më vjen në mendje kjo gjë, mendoj për njerëzit, që vdesin urie, dhe ndiej dhimbje. Peshku është një burim shumë më i sigurt proteinash se mishi. Sa e mrekullueshme do të ishte po të bënim qofte peshku, apo salsiçe peshku, dhe t'ua jepnim njerëzve të varfër që jetojnë në Tokë!

Sapo më erdhi ky mendim, fillova projektet për të përpunuar dhe

magazinuar sasi të mëdha peshku. Nuk ia vlen fare të kapësh sasi të mëdha peshku, nëse nuk i administrosh si duhet më pas. Madje, edhe peshku më i mirë nuk mund të ruhet mirë për më gjatë se tetë muaj. Edhe sikur të jenë të ngrirë dhe të vënë nëpër frigoriferë, ajri futet midis të çarave të akullit dhe uji rrjedh. Ju mund t'i hidhni përsëri ujë peshqve dhe mund t'i ngrini përsëri, por, atëherë, aroma e mirë ikë dhe peshku, fare mirë, mund të flaket.

Mblodhëm peshkun, që po e hidhnin, dhe bëmë kërkime si ta kthenim atë në pluhur peshku. U përpoqëm të bënim një gjë që, madje, as vendet e avancuara, si Franca dhe Gjermania, nuk e kishin bërë. Peshku i kthyer në pluhur mund të transportohet dhe magazinohet me lehtësi, madje, edhe në klima të nxehta dhe me lagështirë. Mielli i peshkut ka 98 për qind proteinë; është ndër produktet ushqimore me përmbajtje proteine më të lartë. Prandaj mund të përdoret për t'i shpëtuar njerëzit nga uria. Mielli i peshkut mund të përdoret edhe për të bërë bukë. Jemi ende duke bërë kërkime mbi mënyrën si mund ta vëmë këtë gjë në dispozicion të vendeve të varfra anembanë botës.

Oqeanet përmbajnë sasi të pafundme rezervash ushqimore, por metoda më e mirë për të shpëtuar njerëzimin nga krizat e mungesës së ushqimit janë rezervatet e peshkut. Parashikoj që do të ketë ndërtesa të ngjashme me pallatet shumëkatëshe, që shohim në qytetet tona sot, kushtuar rezervateve të peshqve. Duke përdorur sisteme me tubacione uji, mund të rrisim peshq në ndërtesa të larta, ose edhe në majë të maleve. Me anë të kultivimit të peshkut mund të prodhojmë ushqim më se të mjaftueshëm për të ushqyer gjithë popujt e botës.

Oqeani është një bekim që na është dhënë nga Zoti. Kur dal në oqean, jepem plotësisht pas peshkimit. Kam kapur të gjithë llojet e peshqve në vende të ndryshme. Një arsye përse peshkoj është t'u mësoj njerëzve që

nuk dinë të peshkojnë. Në Amerikën Jugore shpenzova disa muaj rresht duke u mësuar vendasve metodat e mia të peshkimit. Merrja disa rrjeta peshku të ngatërruara dhe shpenzoja tri-katër orë, duke u treguar atyre se si shplekseshin.

Për të siguruar furnizimin e duhur ushqimor me një kosto të ulët, njerëzimit do t'i nevojitet të zhvillojë oqeanin. Oqeani dhe kullotat e mëdha, ende në gjendjen e tyre parahistorike, janë magazinat tona të fundit, të pasurisë. Megjithatë, kjo detyrë nuk do të jetë e lehtë. Do të na duhet të shkojmë në vende shumë të nxehta dhe me lagështirë, ku lëvizja dhe të punuarit shumë, me një ndjenjë të fortë dedikimi, do të bëhet shumë e vështirë. Zhvillimi i kullotave në rajonet tropikale nuk mund të bëhet pa dashurinë pasionante dhe të përkushtuar për njerëzimin.

Zhardimi, në Brazil, është një vend i tillë. Vend mjaft i vështirë për të jetuar. Koha është e nxehtë dhe insekte, që nuk u dihet as emri, të pickojnë vazhdimisht. Kam jetuar në atë vend dhe kam bërë miqësi me të gjitha krijesat e shumëllojshme aty. Kam ecur zbathur, duke ndier dheun e kuq të Zhardimit poshtë këmbëve, duke marrë pamjen e një bujku. Kur isha në lumë duke peshkuar, dukesha si një peshkatar i asaj zone. Vetëm kur vendasit të shohin e të thonë: “Ti je një bujk i vërtetë”, ose “Ti je një peshkatar i vërtetë”, vetëm atëherë ti je i kualifikuar të marrësh njohuritë e tyre dhe të ndash me ta ato që di ti vetë. Nuk është diçka që mund të bëhet nga dikush, i cili ka nevojë të flejë tetë orë në natë në një krevat të pastër dhe të rehatshëm, të hajë tri vakte në ditë dhe të dremisë nën hijen e ndonjë peme.

Kur po zhvillonim një projekt në Paraguai, me një grup anëtarësh, jetonim në një kasolle të vogël në Olimpo, pranë lumit Paraguai. Kishim vetëm një banjë, kështu që, çdo mëngjes, na duhej të prisnim radhën për ta përdorur. Ngrihesha çdo mëngjes në orën tre, bëja disa ushtrime dhe

pastaj shkoja për peshk. Për shkak të kësaj, anëtarët që ishin me mua kaluan kohë mjaft të vështira. Ata nuk ishin mësuar të nxirrnin karrema që herët në mëngjes, para se t'u ishin hapur sytë plotësisht.

Për të arritur në vendin e ankorimit na duhej ta nxirnim barkën për mes pronave të tjera. Hapja e dyerve të këtyre pronave, në mes të errësirës katran, ishte e vështirë. Një mëngjes, kur anëtarët qorrrolliseshin me një kyç, ngaqë nuk ishin në gjendje ta hapnin, u bërtita: “Çfarë po bëni?!”. Bërtita aq fort dhe ashpër, sa edhe vetë u çudita. Jam i sigurt që për ta duhet të ketë qenë e vështirë, por e ndiej që nuk e përballoj dot të humb as edhe një sekondë të vetme. Nuk kam aspak kohë për t'u vërdallosur kot. Mund të shikoj qartë një listë të tërë gjërash, që duhet t'i bëj para se të mund të vijë një botë e paqes, kështu që zemra ime është gjithmonë në ngut.

Kur peshkoja atje, mbi lumë, para agimit, mushkonjat dyndeshin tamam si një re e zezë. Thumbat e tyre ishin aq të mprehtë, sa mund të shponin përnjëherë edhe pantallonat xhins. Në errësirën para agimit, nuk arrinim të shikonim as tapën e fijos së peshkimit, kështu që na duhej të lidhnim me to qese plastmasi të bardha. Nuk prisja dot lindjen e diellit. Isha në ngut të madh.

Ende më merr malli për Zhardimin. Më merr malli për çdo gjë që kishte atje. Kur mbyll sytë, ndiej ende nxehtësinë e ajrit në Zhardim, që përplasej mbi fytyrën time. Parehatitë e vogla të trupit nuk ishin asgjë. Vuajtjet e trupit kalojnë shpejt. Ajo që ka rëndësi është fakti që ky vend, një ditë, mund të luajë një rol domethënës në shërbimin ndaj botës. Të qenit në Zhardim më krijoi një lumturi të madhe në zemër.

Përtej bamirësisë për t'i dhënë fund urisë

Për të zgjidhur problemin e urisë duhet të kemi një zemër të duruar, që është e gatshme të mbjellë fara. Farat mbillen dhe presin pa u dukur, nën tokë, derisa të jenë të afta të çajnë mbrojtësen e tyre të jashtme. Ngjashëm me këtë, është më mirë ta mësosh një person si të mbjellë dhe të korrë grurin, dhe si ta bëjë atë bukë, se t'i japësh një copë bukë dikujt që është gati duke vdekur. E para mund të jetë më e vështirë dhe mund të mos vlerësohet edhe aq nga publiku, por është mënyra e vetme për të arritur një zgjidhje themelore dhe të qëndrueshme në lidhje me urinë në botë. Duhet të fillojmë të studiojmë klimën, tokën dhe karakterin e njerëzve të zonave që vuajnë nga uria.

Ekziston një lloj peme që quhet moringa. Banorët e Kongos i ushqejnë fëmijët e tyre me gjethe të kësaj peme, që kanë vlera të larta ushqimore, për të plotësuar racionet e ushqimit të tyre. Me to, ushqejnë edhe gjedhët e tyre për t'i shëndoshur përpara se t'i çojnë në treg për t'i shitur. Ata gjithashtu i shtypin gjethet e kësaj peme në një mulli guri me pak vaj dhe pastaj i skuqin me gjalpë për t'i ngrënë.

Mund të jetë një ide e mirë të mbjellësh shumë pemë moringa dhe t'i bluash të gjitha pjesët e saj për t'i bërë miell, përveç rrënjës e cila është helmuese. Mielli mund të përdoret për bukë. Shumë kombe mund ta

ndjekin këtë shembull dhe të mbjellin pemë moringe. Gjithashtu edhe karçofi i Jeruzalemit, i cili ngjan me patatet e ëmbla, rritet shumë shpejt pasi mbillet në tokë. Sasia që mund të vilet prej tyre është tri herë më e madhe se nga ndonjë drithë tjetër, që përdoret për të zbutur urinë. Mbjellja e shumë karçofëve është një mënyrë tjetër për të zgjidhur problemin e urisë.

Në Zhardim përdoret një krimb toke i madh, për kultivim, i cili e bën tokën shumë pjellore. Ky krimb toke ekziston vetëm në Amerikën e Jugut, por ndoshta mund të studiojmë ekologjinë e tij dhe mund ta përdorim për të ndihmuar bujqësinë në rajone të tjera. Koreanët po punojnë në rajonin Mato Grosso për të studiuar krimbin e mëndafshit. Nëse kultivimi i krimbit të mëndafshit atje është i suksesshëm, do të bëhet e mundur të prodhohet mëndafsh me kosto më të ulët, i cili mund të shitet për të blerë ushqim.

Nuk ka zgjidhje të shpejtë për problemin e urisë në botë. Njerëzit, në çdo vend kanë shije të ndryshme për ushqimin dhe zakone të ndryshme, ashtu si dhe bimët dhe kafshët janë të ndryshme. E rëndësishme është të shqetësohemi për fqinjin tonë. Së pari, duhet të zhvillojmë një zemër të tillë që, kur kemi për ngrënë mjaftueshëm sa për të mbushur stomakun tonë, të mendojmë për ata që janë të uritur dhe të përpiqemi si t'i ndihmojmë ata. Paqja e vërtetë nuk do të vijë, për sa kohë që njerëzimi nuk ka zgjidhur ende problemin e urisë.

Nëse personi në krahun tim është duke vdekur nga uria, paqja është thjesht një luks.

Mësimi i aftësive të nevojshme për t'u bërë të pavarur në prodhimin e ushqimit, është po aq i rëndësishëm sa edhe shpërndarja e ushqimit drejtësisht atyre që kanë nevojë. Për të mësuar teknika të tilla, duhet të ndërtojmë shkolla në zona të thella për të luftuar analfabetizmin. Shkol-

lat teknike duhet të krijohen në mënyrë që t'u japin njerëzve aftësinë për të mbajtur veten. Perëndimorët, që pushtuan Afrikën dhe Amerikën e Jugut, nuk bënë aq sa duhet për t'u dhënë teknologjinë njerëzve që jetonin tashmë atje. Ata vetëm e përdorën popullin si krah pune ndërsa përpiqeshin të gërmonin dhe të merrnin me vete pasuritë e fshehura nën tokë. Ata nuk u mësuan njerëzve si të merreshin me bujqësi apo si të drejtonin një fabrikë. Kjo nuk qe e drejtë. Kisha jonë, që në fazat e para të punës misionare në vende të huaja, themeloi shkolla, në vende të tilla si Kongo, për të dhënë mësim mbi agronominë dhe teknologjinë industriale.

Një problem tjetër, me të cilin përballen popujt që vuajnë nga uria, është se ata nuk mund të paguajnë trajtimin mjekësor kur sëmuren. Në anën tjetër të botës, vendet e zhvilluara po shohin një mbipërdorim të ilaçeve, por njerëzit e uritur, shpesh, vdesin sepse nuk blejnë dot një ilaç të thjeshtë për diarrenë. Prandaj, ndërsa punojmë për të zhdukur urinë, duhet të sigurojmë gjithashtu edhe mbështetje mjekësore. Duhet të ngremë klinika dhe të kujdesemi për ata që vuajnë nga sëmundje kronike.

Për shembull, në kuadër të fermave “Shpresa e re” në Zhardim, Brazil, unë dhurova autoambulanca dhe paisje mjekësore për mbi tridhjetë qyteza të kësaj zone. E krijova fermën Shpresa e Re, si model, për të treguar se si njerëzit mund të jetojnë së bashku në paqe. Lëruam një pjesë të madhe toke për ta bërë të punueshme dhe ndërtuam një fermë bagëtitsh lart në kullota. Megjithëse fermat e “Shpresës së re” janë në Brazil, ato nuk i përkasin vetëm popullit të Brazilit. Kushdo që është i uritur mund të shkojë në fermat e “Shpresës së re”, mund të punojë dhe mund të ushqehet atje. Rreth dy mijë vetë nga të gjitha racat dhe nga të gjitha viset e botës mund të hanë e të flenë atje pa problem. Do të

ngremë shkolla që nga fillorja deri në universitet. Njerëzve do t'u jepet mësim si të merren me bujqësi dhe si të rrisin bagëtinë. Gjithashtu do t'u mësojmë atyre si të mbjellin dhe të rrisin pemë dhe si të kapin, të përpunojnë dhe të shesin peshk. Nuk kemi vetëm një fermë. Përdorim liqenet e panumërt që gjenden në afërsi të lumit për të krijuar rezervate peshku dhe vende peshkimi.

Rajoni i Çakos, në Paraguai zë 60 për qind të territorit të atij vendi, por ka qenë një tokë e lënë në harresë. Rajoni i Çakos është formuar kur deti u ngrit dhe mbuloi tokën, kështu që edhe tani gjen ujë të kripur që buron kur gërmon tokën. Isha rreth të shtatëdhjetave kur shkova për herë të parë në Paraguai. Jeta e njerëzve në tokën e lënë në harresë për një kohë të gjatë ishte aq e varfëruar, sa nuk shprehet me fjalë. Kisha një dhimbje të madhe në zemër kur i shikoja. Unë doja t'i ndihmoja ata sinqerisht, por ata nuk ishin të përgatitur të më pranonin lehtë mua: Një person me ngjyrë tjetër lëkure, që fliste gjuhë tjetër.

Sidoqoftë, unë nuk u dorëzova. Udhëtova përgjatë lumit Paraguai për tre muaj, duke ngrënë dhe duke fjetur me njerëzit e asaj zone. Në moshë përtej të shtatëdhjetave po ndërmerrija një detyrë për të cilën njerëzit thanë se ishte e pamundur. U mësova njerëzve që takoja atë çfarë dija rreth peshkimit, ndërsa ata më mësuuan gjuhën e tyre. Ishim në një barkë së bashku për tre muaj dhe, kështu, u bëmë shokë.

Sapo filluan të hapin zemrën, u flisja përsëri e përsëri rreth faktit se pse bota duhet të bëhej një. Në fillim, reagimi i tyre ishte indiferent. Megjithatë, vit pas viti, njerëzit në Paraguai filluan të ndryshojnë. Pas dhjetë vjetësh, ndryshuan aq shumë, sa organizuan me entuziazëm të madh një festival global të paqes.

Zgjidhja e situatës së ushqimit nuk do të thotë se paqja do të vijë menjëherë pas kësaj. Pasi të zgjidhet çështja e urisë, është e rëndësishme

të fillojnë programe edukimi për paqen dhe dashurinë. Unë kam ndër-
tuar shkolla në vende si Zhardimi dhe Çako. Në fillim njerëzit nuk i
dërgonin fëmijët në shkollë, por në vend të kësaj, i përdornin për të
ndihmuar në rritjen e bagëtive. Punuam shumë për t'i bindur se fëmijët
dhe të rinjtë kanë nevojë për arsimim. Si rrjedhojë, tani kemi shumë
nxënës. Ndërtuam një fabrikë të industrisë së lehtë, ku ata arritën të
prodhojnë produkte me një teknologji të thjeshtë, kështu që nxënësit u
bënë më të interesuar për të ndjekur shkollën, në mënyrë që të mund të
punonin në fabrikë.

Të gjithë jemi përgjegjës për njerëzit që vdesin nga uria anembanë
botës. Duhet të veprojmë për t'i ndihmuar ata. Duhet të kemi një ndjen-
jë të qartë përgjegjësie, të gjejmë një mënyrë që edhe ata mund të ush-
qehen dhe shpëtohen. Njerëzit që jetojnë mirë duhet të zbresin në një
pozitë pak më të ulët dhe të ngrenë ata që jetojnë në varfëri, për të sjellë
një botë ku të gjithë njerëzit jetojnë mirë.

faqe bosh